



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ODETA DERVISHI  
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE  
TIRANE, RR. DIBRES, PALLATI NR.  
7/5, SHKALLA NR. 1, AP. NR.2  
TEL: +3550694014113

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3591

Nr. koleksioni: 1529

Tirane më 20/05/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024053910161835743



A2024053910161835743

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI****( TË SHOQËRISË "Evo Fashion Style" SH.P.K)**

Sot, më datë 20, 05.2024, para meje Notere ODETA DERVISHI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE TIRANE, RR. DIBRES, PALLATI NR. 7/5, SHKALLA NR. 1, AP. NR. 2, u paraqit personalisht:

**SHITES:**

Enea Sula, atësia Rifat, amësia Ludjana, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr,Arkitekt Kasemi; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Tiranë 3; 0000; Tiranë, lindur më 16/08/1998, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039287591 dhe nr. personal J80816063D, .

**SHITES:**

Idlir Hysi, atësia Bujar, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Rr,Arkitekt Kasemi; Njësia Administrative Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 08/01/1992, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034506027 dhe nr. personal J201080670, .

**BLERES:**

Alban Senka, atësia Qazim, amësia Dyzene, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Shefqet Kuka; Nd. 231; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 4; Njesia Bashkiake Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 27/11/2002, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036195679 dhe nr. personal K21127042M, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë ""Evo Fashion Style" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**BAZA LIGJORE**

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

**TE DHENA PARAPRAKE**

- A. Shitësit zotërojnë nga 1( nje) kuote seicili qe perfaqesojne 50% seicili te Kapitalit te Shoqërisë "Evo Fashion Style" SHPK një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar e





A2024053910161835743

qe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS-NIPT M41428035B me seli ne adresen: Rruga Endri Kerko ap.15, Njesia Administrative nr 3 Tirane.

- B. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000,00, (njqind mije lekë), ne kete menyre: Ortaku Shaban Demiraj zoteron nje kuote prej 50% te kapitalit ne vleren 50.000 leke dhe ortaku Shkelzen Ramaj zoteron nje kuote prej 50% te kapitalit te shoqerise ne vleren 50.000 leke
- C. Me anë të kësaj kontrate Shitësit Ildir Hysi dhe Enea Sula me anë të shitblerjes, kuoten e barabarte me 33 % të kapitalit të Shoqërisë “Evo Fashion Style” shpk, ne vlere kapitali 100,000leke (njqind mije) leke.
- D. pales Shitese Ildir Hysi dhe Enea Sula Z. Shkelzen Ramaj qe perfaqesojnë 33 % të kapitalit të Shoqërisë “BaEvo Fashion Style” shpk,
- E. Në përputhje me Nenet e Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit shqiptar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Nr. 9901, date 14.04.2008 me ndryshet perkatese, Asambleja e Ortakeve te shoqerise ka marre vendimin perkates, per shitjen tek Bleresi te kuotave si me sipër.

Palet bien dakord per nenshkrimin e kesaj kontrate per shitjen e kuotave nepermjet Shitesit dhe Bleresit (“Kontrata per Shitjen e Kuotes” ose “Kontrata”), si me poshte vijon:

## Neni 1

### Perkufizime

- 1.1 Pervec shprehjeve te tjera te perkufizuara ndryshe ne kete Kontrate, per qellimet e saj, fjalet dhe shprehjet qe vijojne do te kene kuptimin e meposhtem:

“Kontrate” do te thote kjo Kontrate per Blerje Kuote – duke perfshire si pjese perberese te saj, deklaratat paraprake te mesiperme;

- A. “Shoqeria” Shoqeria “Evo Fashion Style” shpk, eshte nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, me NIPT M4142835Bme seli ne adresen: Rruga Endri Kerko ap.15, Njesia Administrative nr 3 Tirane.

“Barre” do te thote cdo hipoteke, detyrim, peng, garanci, e drejte zgjedhjeje, kufizim, e drejta e parablerjes, e drejta per t’u ofruar i pari ne blerje, e drejta ose interesi i nje pale te trete, barre ose interesa siguruese te cdo lloji, ose cdo lloj tjetër marreveshjeje preferenciale (duke perfshire por pa u kufizuar ne transferimin e nje titulli ose te nje marreveshje kontrolluese) me efekte te ngjashme;

“Pala” ose “Palet” do te thote Bleresi ose Shitesi ose te dy se bashku, sic e kerkon permbajtja;

## Neni 2

### Objekti i Kontrates

- 2.1 Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate (“Data e Nenshkrimit”), Shitesit Enea Sula dhe Ildir Hysa i shesin Bleresit Alban Senkaa dhe Bleresi Alban Senka blen nga Shitesve Ildir Hysi dhe Enea Sula 1 kuote qe perfaqeson me 33 % të kapitalit të Shoqërisë “Evo Fashion Style” shpk, te lire nga cdo Barre.





A2014053910161835743

- 2.3 Kuota ne shitje do te transferohen juridikisht nga pronesia e Shitesve ne pronesi te Bleresit dhe pala Blerese do te behet zoteruesi ligjor i kapitalit prej 33/% ne shitje menjehere pas regjistrimit te kesaj kontrate prane QKB-se.

### Neni 3

#### Çmimi i shitjes

- 3.1 Çmimi i shitjes i pagueshëm nga blerësi për kuotat që zotëron shitësi e që shiten, është 30, 000 (tridhjetë mijë) leke, vlerë që është paguar jashtë zyrës së noterisë, me pelqim të paleve.

### Neni 4

#### Deklarimet dhe Garancite e Shitesit

- 4.1 Shitesi deklaron dhe garanton ne lidhje me transakcionin qe parashikohet ne kete Kontrate, per te gjitha ceshtjet qe vijojne.
- 4.1.1 *Autorizimi* – Te gjitha veprimet, aktet dhe / ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe / ose aktet e Shoqerise qe duhet te ndermerren nga ose per llogari te Shitesit dhe qe autorizojne Shitesin te lidhe dhe te zbatoje kete Kontrate jane kryer rregullisht. Kjo Kontrate eshte nenshkruar dhe dorezuar rregullisht nga Shitesi dhe perben nje detyrim te vlefshem dhe ekzekutiv per Shitesin dhe qe duhet zbatuar prej tij, ne perputhje me kushtet dhe afatet e Kontrates.
- 4.1.2 *Nenshkrimi* – Nenshkrimi i kesaj Kontrate nuk kerkon asnje depozitim, miratim, autorizim te cfaredolloji nga ndonje autoritet shteteror ose pale e trete pervec miratimit nga asambleja e shoqerise.
- 4.1.3 *Pronesia* – Shitesi eshte pronari i vetem dhe i ligjshem i Kuotes ne shitje. Kuota eshte percaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe jane shlyer plotesisht nepermjet kontributit ne para ne kapitalin themeltar te Shoqerise.
- 4.1.4 *Kuota* - Kuota eshte e lire dhe e cliruar nga cdo Barre e cfaredo lloji dhe Shitesi ka te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per t'a shitur, per t'a kaluar, transferuar dhe dorezuar Kuoten ne perputhje me afatet e kesaj Kontrate. Nuk ka asnje kontrate, marreveshje ose detyrim qe krijon ose vendos ndonje Barre ne lidhje me Kuoten ose ndonje numer Kuotash te autorizuar por te paemtuara ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka ndonje te drejte mbi ndonje Barre lidhur me ndonje nga Kuotat. Pervec kesaj Kontrate, nuk ka asnje kontrate, marreveshje, ose detyrim qe parashikon dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin ose dhenien e se drejtes nje personi, te drejten e parablerjes apo te kembimit, ne lidhje me Kuoten objekt te kesaj kontrate.
- 4.1.5 Mbi blerësin nuk rëndon asnjë detyrim i lindur mbi kuoten që zotëron shitësi deri ne momentin e kalimit të pronësisë të saj.
- 4.1.6 *Me nenshkrimin e ketij akti noterial pales Blerese i kalon pronesia mbi kuoten qe perfaqeson 33% te kapitalit te shoqerise Evo Fashion Style SHPK dhe kjo shoqeri ao te perbehet nga tre ortake dhe konkretisht Idlir Hysi me kuoten qe perfaqeson 34% te Shoqerise, Enea Sula me kuoten qe perfaqeson 33%, te SHOqerise dhe Alban Senka me kuoten 33% te Shoqerise Evo Fashin Style*



A2024053910161835743

## Neni 5

### Ligji i zbatueshem dhe juridiksioni kompetent

- 6.1 Kjo Kontrate rregullohet nga ligji Shqiptar.
- 6.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis dy palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 6.3 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, pala tjetër i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 6

### Taksa dhe Shpenzime

- 7.1 Taksa për kalimin e kuotave do të paguhet nga shitësi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## Neni 7

### Te ndryshme

- 8.1 Cdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave të kësaj Kontrate, do të jete e vlefshme vetem nese behet me shkrim, me akt noterial dhe nenshkruhet nga ose ne emer te seciles Pale.
- 8.2 Ne rast se nje dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i paligjshem ose i pazbatueshem ne nje juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e ketyre dispozitave ose detyrimeve ne nje juridiksion tjetër, nuk do te preket nga nje fakt i tille.
- 8.3 Palet do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pazbatueshme ose te pavlefshme, ne masen me te madhe te mundshme, per te arritur qellimin e kesaj dispozite.
- 8.4 Kjo Kontrate nenshkruhet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen shqipe.
- 8.5 Asnjera Pale nuk mund te kaloje dhe / ose te transferoje te drejatat dhe / ose detyrimet sipas kesaj Kontrate, ne teresi ose ne vecanti, pa miratimin paraprak me shkrim te Pales tjetër.

## Neni 8

### Legjislacioni i Zbatueshëm

- 9.1 Kjo kontratë, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe vençanërisht, dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me ndryshimet përkatëse.

## NENI 9

### ANEKSET E KONTRATËS

- 9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve;
- Ekstrakt i Regjistrit Tregtar për Shoqërinë
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;





A2024053910161835743

- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

### PALËT KONTRAKTUESE

#### SHITES

Enea Sula *Enea Sula Q.*

#### SHITES

Idir Hysi *Idir Hysi*

#### BLERES

Alban Senka *Alban Senka*

Notere  
ODETA DERVISHI

